



Datë: 29.07.2025
Numër Protokolli: 5733/2025

A.nr.1169/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1169/2025, të datës 19.06.2025, të parashtruar nga ankuesi F.G kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.1169/2025, e datës 19.06.2025, e parashtruar nga ankuesi F.G, ashtu që, **aprovohet** pretendimi i ankuesit për kompensim të pagave të ndaluara si rezultat i Vendimit me numër protokolli 3408, të datës 30.12.2024, të Komisionit Disiplinor, të Inspektoratit të Punës, ndërsa, **refuzohen** pretendimet për anulim të procedurës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe marrëveshjes për transferim të datës 11.04.2024, të lidhur mes Inspektoratit të Punës dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit.

II. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesit t’i kompensoj pagat e ndalura si pasojë e zbatimit të vendimit më nr.protokolli 3408, të datës 30.12.2024, të Komisionit Disiplinor, të Inspektoratit të Punës.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil F.G (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 19.06.2025, përmes emailit ankesa.kpmsbck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Inspektoratit të Punës për shkak të diskriminimit dhe pamundësisë për të aplikuar në konkursin me Nr. Ref: RN00017489, pozita Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative, jo ligjshmërisë së marrëveshjes të datës 11.04.2024 të lidhur mes Inspektoratit të Punës dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit për transferim të përhershme të D.H

dhe për shkak të mos kompensim të pagave të ndaluara si rezultat i Vendimit me numër protokolli 3408, të datës 30.12.2024, të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave, me datë 10.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa, ky i fundit, më datë 16.07.2025, ka përcjell provat materiale ndërlidhur me çështjen në procedurë duke mos dhënë përgjigje në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 19.06.2025 nga N.S për ankuesin; Kërkesën përmes emailit të datës 19.06.2025 nga ankuesi për N.S; Emailin e datës 03.06.2025 nga ankuesi për B.B, L.B, R.P. N.S, B.L, K.S dhe F.K; Emailin e datës 12.06.2025 nga R.P për ankuesin; Emailin e datës 10.06.2025 nga ankuesi për R.P; Emailin e datës 16.06.2025 nga ankuesi për B.B; Emailin e datës 13.06.2025 nga ankuesi për R.P; Emailin e datës 12.06.2025 nga D.H për R.P; Emailin e datës 11.06.2025 nga R.P për D.H; Emailin e datës 10.06.2025 nga ankuesi për R.P; Emailin e datës 15.05.2025 nga N.S për ankuesin; Kopjen e ID-së së ankuesit; Provë shtesë nga ankuesi ; Marrëveshjen për transferim të përhershëm datë 11.04.2024; Akt Emërimit me Nr. 03.2024 të datës 21.11.2024 për D.H; Akt Emërimit e datës 06.03.2017 për ankuesin; Njoftimin për rezultatet përfundimtare i datës 20.06.2025 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative; Emailin e datës 14.06.2025 nga ankues për A.B; Emailin e datës 10.07.2025 dhe 09.07.2024 nga ankues për R.P, N.S dhe B.B; Emailin e datës 17.07.2025 nga ankuesi për R.P dhe N.S; Vendimin e datës 17.07.2025 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 16.07.2025; Konkursin me Nr. Refrence:RN00017489 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative; Njoftimin e datës 25.05.2025 për verifikim paraprak për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative; Vendimin e datës 25.01.2023; Kërkesën për rishqyrtim të përgjegjësisë disiplinore për ankuesin datë 04.06.2025; Formatuarin për ndryshime në pagë datës 17.06.2025; Vendimin e datës 30.12.2024 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës; Vendimin A.nr.236/2025 të KPMSHCK-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se:

-Ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 57/2017 të datës 06.03.2017, i korrigjuar sipas Vendimit Nr.06/2023, të datës 25.01.2023, është i punësuar në Inspektoratin e Punës dhe së i njëjti ushtron pozitën Zyrtar i Lartë, në Divizionin për TI dhe Shërbime të Logjistikes.

-Ushtruesi i detyrës së Udhëheqësit të Divizionit për Logjistikë dhe IT-së, më datë 18.11.2024, kishte iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit për shkak të mungesave në punë, ndërsa, më datë 06.12.2024, është bërë plotësimi i kërkesës për inicim të procedurës disiplinore nga znj.D.H si udhëheqëse e drejtpërdrejtë e ankuesit, ashtu që, pretendohet së ankuesi nuk është paraqitur në punë prej datës 21.11.2024 e tutje.

- Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës më Vendimin me numër protokolli 3408, të datës 30.12.2024, ka shpall përgjegjës ankuesin për shkelje të rëndë disiplinore “ *Braktisje e punës ose mungesa e paarsyeshëm*”, sipas nenit 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.10 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”.

-Ankuesi më datë 29.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokolli 3408, të datës 30.12.2024, të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, ndërsa, ky i fundit më Vendimin A.nr.236/2025, të datës 28.03.2025, ka shfuqizuar Vendimin me numër protokolli 3408, të datës 30.12.2024, të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, duke e obliguar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të ankuesit të rishqyrtoj rastin në fjalë.

-Si rezultat i Vendimit A.nr.236/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankuesit më datës 04.06.2025, kishte paraqitur kërkesë për rishqyrtimin e përgjegjësisë disiplinore të ankuesit pranë Komisionit Disiplinor, ndërsa Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës më datë 17.07.2025 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 1399, me të cilin ka hedhë poshtë iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit.

-Me tej, nga provat materiale të çështjes del së Inspektorati i Punës më datë 25.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Ref: RN00017489 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe së më datë 20.06.2025, është publikuar njoftimin për kandidatin fitues, për këtë pozitë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar më datë 19.06.2025, pretendon se Vendimi me numër protokolli 3408, i datës 30.12.2024, të Komisionit Disiplinor të IP-së ishte ekzekutuar dhe nuk i kishte funksionuar emaili zyrtar e për rrjedhojë edhe i është mohuar e drejta për të aplikuar në konkursin me Nr. Reference: RN00017489 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative; Tutje, shton së marrëveshja për transferim në mes të Inspektoratit të Punës dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit për transferimin e D.H është e kundërligjshme ngase është nënshkruar nga H.N i cili sipas vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është konstatuar se nuk ka autorizim ligjor; Pretendon se Vendimi me numër protokolli 3408, i datës 30.12.2024, i Komisionit Disiplinor i njëjti ishte ekzekutuar në kundërshtim me ligjin dhe përveç që nuk ka vijuar punën i është ndaluar edhe paga. Kërkon që të aprovohet ankesa, të obligohet Inspektorati i Punës që të përfshijë në listën e pagave dhe të njëjtat të kompensohet në mënyrë retroaktive, të anulohet konkursi për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative, dhe të shfuqizohet marrëveshja për transferim te zyrtares. D.H.

Referuar pretendimit për kompensim të pagave të ndaluara dhe duke qenë së organi i punësimit më asnjë provë nuk ka dëshmuar se ka zbatuar parimin e efektit suspensiv të ankesës lidhur me vendimin me numër protokolli 3408, të datës 30.12.2024, të Komisionit Disiplinor, më të cilin ankuesit i ishte shqiptuar masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, Kolegji konstaton së në rastrin konkret Inspektorati i Punës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 144, paragraf 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin*

*e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës. Për me tepër, Këshilli Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes kërkesës për përgjigje në ankesë të datës 31.01.2025, kishte njoftuar Njësinë e Personelit të IP-së se: **Sqarim:** Duke marr për bazë dispozitat e nenit 130 paragrafi 1 dhe nenit 144 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ju bëjmë me dije se aktet ndaj të cilave parashtrohet ankesë në Këshill, nuk mund të ekzekutohen pasi që sipas fuqisë së ligjit, parashtrimi i një ankese pezullon sipas fuqisë së ligjit prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën.*

Andaj, mbi bazën e konstatimit si më sipër, dhe duke qenë së Komisioni Disiplinor i IP-së më Vendimin me numër protokolli 1399, të datës 17.07.2025, ka hedhur poshtë kërkesën për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, Kolegji vlerëson së mbi këtë gjendje të fakteve dhe rrethanave juridike pretendimi ankimor i ankuesit për kompensim të pagave të ndaluara është i bazuar, kështu që, siç u përcaktua në pikën II të dispozitivit të vendimit, obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Inspektoratit të Punës që ankuesit ti kompensoj në mënyrë retroaktive pagat e ndaluara si rezultat i zbatimit të Vendimit me numër protokolli 3408, të datës 30.12.2024, të Komisionit Disiplinor, dhe atë deri në muajin qershor 2025 (sipas provave të lëndës nga data 12.06.2025 ankuesi është kthyer në vendin e punës dhe sipas formularit të datës 17.06.2025 është dërguar në listë të pagave).

Ndërlidhur me pretendimin ankimor për mohim të së drejtës së ankuesit për të aplikuar në konkursin me Nr. Ref: RN00017489, pozitën Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative, mbi arsyet sikurse në ankesë, Kolegji thekson faktin së ankuesi në kuptim të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, është dashur të ushtroj ankesë pas shpalljes së rezultateve përfundimtare në afat prej tridhjetë (30) ditëve, pra, ankuesi më ankesë të veçantë duhej të atakonte procedurën në fjalë dhe mbi bazën ankimore sikurse në ankesën e datës 25.06.2025, kështu që, mbi këto rrethana Këshilli vlerëson së pretendimi ankimor nuk gjen mbështetje dhe si i tillë konsiderohet i pabazuar.

Përkitazi më pretendimin ankimor se marrëveshja në mes Inspektoratit të Punës dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit për transferimin e përhershëm të D.H është e kundërligjshme ngase është nënshkruar nga H.N, i cili sipas vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është konstatuar se nuk ka autorizim ligjor, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 7, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet se: “3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil.”, si dhe nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më të cilin përcaktohet se : 1.Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtar i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë”, konstaton së lidhur me këtë pretendim palës ankuese i mungon legjitimiteti i palës, për faktin se ankuesi nuk ka arritur të argumentoj se cila e drejtë apo cili interes nga marrëdhënia e tij e punës është cenuar si rezultat

i marrëveshjes nr.prot:1001 të datës 11.05.2024, për transferimin e përhershëm të znj. D.H, nga pozita Zyrtare e TI në Organin Shqyrtues të Prokurimit në pozitën Zyrtare e TI-së në Inspektoratin e Punës, andaj, mbi këto arsye ankesa e ankuesit lidhur me këtë pretendim është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1, nënpika 1.2, ndërlidhur me nenin 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Thënë si më lartë, Kolegji duke u bazuar nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1169/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit F.G;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së